



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 4/285
Date: 29.12.2021

Mbështetur në nenin 17 të Kodit të Etikës për stafin akademik të Universitetit të Prishtinës (Nr. 1/751, dt. 19/07/2013), sidomos dispozitave të neneve 6, 7 dhe 8 të Rregullores për Masat dhe Procedurat Disiplinore ndaj Personelit Akademik të Universitetit të Prishtinës dhe Rregulloren e Punës të Këshillit të Etikës (Nr. 1/629, dt. 14/07/2016), Statutin e Universitetit të Prishtinës, Këshilli i Etikës, në mbledhjen e mbajtur me datën 21.12.2021, njëzëri, mori këtë:

VENDIM

- I. Pushon procedura e filluar sipas denoncimit të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Matematiko Natyrore (FSHMN) Prof. Dr. Idriz Vehapi kundër Prof. Asoc. Dr. Ibrahim Ramadani, Prof. Ass. Dr. Valbon Bytyqi dhe Prof. Asoc Dr. Arsim Ejupi, me nr. të lëndës 6766, datë 24.11.2021.
- II. Këshilli i Etikës thekson edhe një herë si parim të përgjithshëm dhe orientues, se cenimi i rregullave procedurale administrative nuk nënkupton automatikisht edhe cenim i kuadrit normativ lidhur me sjelljet etike.
- III. Këshilli i Etikës vlerëson se Universiteti i Prishtinës ka një kuadër të mirë normativ për vlerësimin e rregullsise materiale dhe procedurale të vendimeve në organet e Fakultetit dhe Universitetit si dhe për sigurimin e mbarëvajtjes të procedurave administrative.
- IV. Këshilli i Etikës thekson sërisht se çështja e zgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik është procedurë e veçantë administrative e rregullar me norma përkatëse juridike.
- V. Këshilli i Etikës i referohet praktikës së deritanishme vendimmarrëse duke theksuar sërisht me vendosmëri, se secili anëtar i Universitetit duhet të kujdeset maksimalisht për respektimin rigoroz të kuadrit normativ, duke përfshirë këtu edhe rregullat përkatëse për zbatimin e konkursit publik.

L. M.

Arsyetim

I. Paraqitja, vlerësimi dhe kualifikimi i të gjeturave faktike


- Me datë 24.11.2021, Dekani i FSHMN, Prof. Dr. Idriz Vehapi i ka drejtuar Këshillit të Etikës një “Shkresë për procedim me supozim të shkeljes së etikës profesionale” kundër komisionit vlerësues në përbërje prej Prof. Asoc. Dr. Ibrahim Ramadani, Prof. Ass. Dr. Valbon Bytyqi dhe Prof. Asoc Dr. Arsim Ejupi “për shkelje me rastin e vlerësimit të dosjeve të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për pozitën 26 sipas konkursit nr. 804, dt. 14.5.2021”.
- Dekani i FSHMN-së Prof. Dr. Idriz Vehapi e ka dërguar këtë denoncim bazuar në vendimin e Senatit të UP-së nr. 3/803 të datës 23.11.2021 të nënshkruar nga Rektori i UP-së me të cilin i kërkoitet Dekanit të FSHMN-së që ta referojë këtë rast në Këshillin e Etikës të UP-së.
- Vendimin e lartpërmendur të Senatit ia ka bashkangjitur denoncimit të tij. Në këtë vendim të Senatit të UP-së thuhet se “Dekani i Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore, për shkak të dyshimit të bazuar për implikim në shkelje të etikës profesionale, obligohet që të referojë në Këshillin e Etikës anëtarët e komisionit vlerësues për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për pozitën nr. 26 sipas konkursit nr. 804, dt. 14.05.2021”.
- Përmes këtij denoncimi, Dekani i FSHMN kërkon që Këshilli i Etikës që ta shqyrtojë këtë rast sa më parë që është e mundur për shkak se pozitat nr. 4 dhe nr. 26 të shpalluara nga FSHMN janë ndaluar deri në një vendim të Këshillit të Etikes.
- Për pretendimet e tij, Dekani i FSHMN nuk ka ofruar më shumë dëshmi për shkeljet e supozuara.
- Me datën 17.12.2021, Këshilli i Etikës ka marre një email anonim nga info@uni-pr.edu të cilit ishin bashkëngjitur disa dokumente të cilat Këshilli i Etikës ka shqyrtuar në mbledhjen e datës 21.12.2021.
- Këshilli i Etikës e ka shqyrtuar këtë rast komfor rregullave përkatëse juridike dhe ka zhvilluar procedurë sipas praktikave të standardizuara përkatëse. Këshilli i Etikës ka shqyrtuar pranueshmërinë ose jo të këtij denoncimi. Varësisht nga (mos) pranueshmëria, Këshilli i Etikës procedon me zhvillimin e mëtejmë të procedurës para Këshillit, fillimisht me zhvillimin e procedurës së komunikimit të shkresave për respektimin rigoroz të parimit të dëgjimit të palës.

- Në mbledhjen e datës 21.12.2021, Këshilli i Etikës ka arritur te konstatimi se nuk janë plotësuar kandidat bazike dhe themelore për pranueshmërinë e këtij denoncimit dhe ka vendosur pushimin e procedurës për shkak të mosplotësimit të kandidateve për fillimin dhe zhvillimin e procedurës para Këshillit.
- Këshilli i Etikës vëren se çështja e avancimit, zgjedhes apo edhe rizgjedhjes në pozitat përkatëse juridike realizohet në konkursin publik, i cili proces sipas rregullave përkatëse juridike është publik, transpartent, objektiv dhe meritor. Për të realizuar këto objektiva, UP qeveriset me një kuadër të avancuar juridik, me të cilin sigurohet mbarëvajtja dhe zhvillimi efikas dhe konsekuent i procedurës për zbatimin e konkursit publik. Në këtë proces, secili individ ka hapurr rrugën juridike për pjesëmarrje dhe për realizimin e të drejtave të tyre të pretenduara.
- Këshilli i Etikës vlerëson edhe me këtë rast se zhvillimi i konkursit publik është një proces i rregulltë administrativ, për të cilin janë paraparë rregullat përkatëse, të cilat rregulla duhet të respektohen me reptyesi dhe me përkushtim nga secili anëtar i Universitetit për të siguruar një proces të rregullt, transparent, objektiv dhe meritor. Në këtë mendohet edhe pjesëmarrja aktive e secilit anëtar në këtë proces sipas detyrave, por edhe rezervimi nga çfarëdo veprimi apo edhe mosveprimi jo etik apo jo kolegjial, që do të mund të ndikonte negativisht në zhvillimin e një procesi të tillë relevant për punën e Universitetit.
- Këshilli i Etikës vëren se në rastin aktual dhe të dhënë nuk mund të konstatohet përtej secilit dyshim të bazuar, se të denoncuarit kanë pasur sjellje të tilla jo akademike dhe jo etike, të cilat do të kishin për pasojë direkte edhe zhvillimin e procedurës para Këshillit të Etikës.
- Këshilli i Etikës thekson sërisht se Universiteti ka një kornizë të avancuar juridike për zhvillimin e procedurave të tilla dhe atë edhe të konkursit publik dhe për këtë për të siguruar mbarëvajtjen e këtij procesi përkundër pengesave eventuale procedurale gjatë zhvillimit të procesit për zbatimin e konkursit publik.
- Secili individ, qoftë i personelit akademik apo jashtë, mund të shfrytëzojë rrugën juridike për realizimin e të drejtave të tyre të pretenduara, siç është rasti edhe i avancimit akademik apo zgjedhes në pozitat e parapara me konkursin publik në UP.
- Këshilli i Etikës edhe me këtë rast thekson me vendosmëri dhe në mënyrë ultimative se secili anëtar i Universitetit duhet të kujdeset për kryerjen e detyrave profesionale me përgjegjësi të lartë akademike dhe etike dhe të rezervohet nga çfarëdo veprimi apo edhe mosveprimi dashakeqës në çfarëdo situate dhe procedure në Universitetin e Prishtinës.
- Sjellj dinjitoze, akademike, etike dhe profesionale e secilit anëtar të Universitetit janë vlera të pacenueshme dhe ultimative të Universitetit të Prishtinës the si të tilla duhet të respektohen me reptyesi.

L. M.

II. Vendimi

Duke marrë për bazë të gjitha rrethanat e rastit, në tërësinë e tyre faktike dhe ligjore, dhe në veçanti kompetencat dhe detyrat, Këshilli i Etikës të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Për dhomat e emër të Këshillit të Etikës

Prof. Dr. Iset Morina
Kryesues